



This project is funded by the European Union



KONKURS - Ekspert ndërkombëtar afat-shkurtër për përdorimin e veglave analitike të të dhënave në luftën kundër korrupsionit, në Komponentin 3 (parandalimi i korrupsionit) në projektin Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit

Punëdhënësi: Agjencia për Integrim European dhe Zhvillim Ekonomik GmbH

Lokacioni: Shkup, Maqedonia e Veriut

Lloji: Angazhim afatshkurtër

Fillimi i pritshëm: Maj 2021

Kohëzgjatja e pritshme: 2 muaj në vitin 2021

HISTORIA

Eksperti afat-shkurtër ndërkombëtar për përdorimin e veglave analitike të të dhënave në luftën kundër korrupsionit në Komponentin 3 (parandalimi i korrupsionit) do të punojë si pjesë e ekipit implementues për projektin e mbështetur nga granti i Bashkimit Europian “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” në Maqedoninë e Veriut. Projekti zbatohet nga një partneritet ndërkombëtar me përvojë i udhëhequr nga Agjencia për Integrim European dhe Zhvillim Ekonomik GmbH dhe tre bashkë-aplikantë – Ministria e Drejtësisë dhe Administratës e Republikës së Kroacisë, Ministria e Brendshme e Republikës së Austrisë dhe Ludwig Boltzmann Institute i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut.

Objektivi i Përgjithshëm i projektit është të forcojë sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut. Projekti ka katër objektiva specifike: 1. Të përmirësojë kapacitetet e institucioneve të drejtësisë për të siguruar drejtësi në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, 2. Të forcojë kapacitetet për zbatim efektiv të teknikave moderne të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar, 3. Të përmirësojë parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe 4. Të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave themelore.

Eksperti ndërkombëtar afat-shkurtër për përdorimin e veglave analitike të të dhënave në fushën e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm në fushën e anti-korrupsionit (Komponenti 3) do të mbështesë Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Liderin e Komponentit për Komponentin 3.

në mbështetje të zbulimit dhe parandalimit të korrupsionit do të mbështesë do të mbështesë Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dhe Drejtuesin e Komponentit për Komponentin 3.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Ndërtimi i kapaciteteve në KSHPK lidhur me përdorimin e veglave analitike të të dhënave në mënyrë që të përmirësojë punën e tyre dhe të palëve të tjera të interesit dhe palëve të interesuara në lidhje me monitorimin e flukseve financiare / pagesat e organeve administrative, konfliktin e interesit dhe lobimin me qëllim të zbulimit dhe parandalimin e korrupsionit.

- Mbështetje KSHPK në zhvillimin e një plani zbatimi për të gjithë procesin, për të pasur një mjet analitik të të dhënave në vend.



This project is funded by the European Union



- Pjesëmarrje në takime me palët e interesuara, trajnime dhe demonstrimin e sistemeve aktuale të vendosura në organet për anti-korrupsion.
- Asistencë Drejtuesit të Komponentit të Komponentit 3 në detyrat e tija.

KËRKESAT

- Rrjedhshmëri në gjuhën angleze, në të shkruar dhe të folur.
- Përvojë nga puna me vegla analitike të të dhënave në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit.
- Përvojë nga puna në ose me institucione të pavarura për anti-korrupsion në vendet e ish-Jugosllavisë.
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi me gojë dhe me shkrim, të ndjeshme ndaj mjedisit politik, aftësi të shkëlqyera analitike, qasje pragmatike, të menduarit strategjik dhe planifikim operacional.
- Fleksibilitet, aftësi të fuqishme për t'u adaptuar dhe aftësi për të punuar në ekip në një mjedis potencialisht stresues nën afate të ngushta.

DORËZIMI I APLIKACIONEVE

Aplikacionet duhet të dërgohen në dragan.kovacevic@aei.at (linku dërgon e-mail) deri më 21 maj 2021, duke shënuar "International Short-term Expert in Data Analytic Tool" në titullin e email-it (subject line) dhe duke përfshirë një CV të formatit Europass në gjuhën angleze dhe një letër motivuese. Aplikacionet e dërguara pas përfundimit të afatit ose aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në një listë më të ngushtë do të ftohen për një intervistë personale.